



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË
AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO
FOOD AND VETERINARY AGENCY

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me numër reference: **AUV, 01-367 /2018**, shpallë të lirë këtë vend të punës:

Lloji i konkursit: **I brendshëm**

Pozita e punës: **Udhëheqës i Sektorit të Mbetjeve në Ushqim**

Lloji i pozitës: **I karrierës**

Lloji i Akt Emërimit: **Orar të plotë**

Grada/Koeficienti: **9**

Procedura e aplikimit: **I brendshëm (avancim)**

Kohëzgjatja e emërimit: **Pa afat**

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja dhe Organizimi i Sektorit të Mbetjeve në Ushqim sipas legjislacionit në fuqi.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Organizimi i të gjitha aktiviteteve në lidhje me Sektorin e Mbetjeve në Ushqim;
- Përpilimi i Planit Nacional për Monitorim të Mbetjeve;
- Përpilimi i Frekuencës së Mostrimit sipas Planit të Monitorimit të Mbetjeve;
- Propozimi i aktiviteteve për implementimin e Planit të Monitorimit të Mbetjeve;
- Grumbullimi, analizimi, përpunimi i të dhënave nga laboratorit i autorizuar për testimin e mostrave të mbetjeve;
- Përcjellja e legjislacionit për mbetjet dhe propozimi i legjislacionit sekondar në lidhje me këtë lëmi;
- Bashkëpunon me mekanizmat vendor dhe ndërkombëtar në lidhje me implementimin e programeve për mbetjet në ushqim;
- Kryen edhe punë dhe detyra të tjera me kërkesën e Drejtorit të Shëndetit Publik të cilit edhe i përgjigjet për punën e vet.

Shkathtësitë e kërkuara (kualifikimi, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera kërkohen për këtë vend të punës):

- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e Mbetjeve në Ushqim;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi kompjuterike të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Shkathtësi organizative dhe komunikuese;
- Diplomë Universiteti - Fakulteti i Mjekësisë Veterinare (Diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës pas vitit 1990 duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT), si dhe
- Katër (4) vite përvojë pune në profesion.

Procedura e konkurimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur vetëm për nëpunës civil ekzistues, të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit.

Kërkesa për plotësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Zona Industriale p.n.

Formularin zyrtar për aplikim mund ta gjeni edhe në Ueb faqen <http://www.auv-ks.org/>

Së bashku me formularin zyrtar të punësimit duhet të dorëzohet dëshmia për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, dëshmitë për përvojën e punës si dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pa kompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pa vlefshëm.

Kërkesat dorëzohen në Zyrën e Arkivës nr. N-103 kati i parë, ndërtesa e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ose me postë.

Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për shkak të numrit të lartë të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Afati i konkurimit është prej datës 05.10.2018 deri me datë 12.10.2018 në ora 16:00.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutem na kontaktoni në numrin: 038/ 200-38-304.